



Republika e Maqedonisë së Veriut  
KOMUNA E VRAPÇISHTIT  
Nr. 08- 1317/1  
25.08.2023

Bazuar në Marrëveshjen për Bashkëpunim ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë – Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në bazë të aktiviteteve të planifikuara në kuadër të projektit për mbrojtje ndërkufitare nga zjarri – Crros border (ndërkufitar) "FRESHIELD", kryetari i komunës së Vrapçishtit hap:

### KONKURS PUBLIK

Për përzgjedhjen e kandidatëve për trajnimin për zjarrfikës

Publikohet konkursi publik për përzgjedhjen e kandidatëve për trajnim për zjarrfikës për nevojat e projektit Ndërkufitar-"FRESHIELD", edhe atë:

#### 1. Zjarrfikës - (4 përmbaues).

Kandidatët për përzgjedhje për trajnim për zjarrfikës aplikojnë në shpalljen publike duke plotësuar një aplikacion dhe duke bashkangjitur dëshmi për plotësimin e kushteve që janë të dhëna në konkurs. Kryetari i Komunës me Vendim themelon Komisionin Përzgjedhës, i cili në afat prej 8 (tetë) ditësh nga skadimi i afatit për regjistrimin e konkursit, kontrollon nëse kandidatët kanë dorëzuar dëshmitë e detyrueshme për plotësimin e kushteve të dhëna në konkurs.

Pas kompletimit të dokumenteve, Komisioni selektues kontrollon të dhënat e paraqitura nga ana e kandidatëve se a janë të gjitha dokumentet e nevojshme për konkurs.

Nëse gjatë kontrollit konstatohet se provat janë të rreme, Komisioni e refuzon kërkesën.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e kriterëve të qarta dhe transparente, të përcaktuara nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes lokale.

Në rast se pas konkursit aplikojnë disa kandidatë që I plotsojnë kushtet, Komisioni Komunal Përzgjedhës ka të drejtë të zhvillojë një intervistë me kandidatët e regjistruar.

Komisioni përzgjedhës përgatit listën e renditjes së kandidatëve dhe ia paraqet kryetarit të komunës, i cili bën përzgjedhjen brenda 15 ditëve.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kushte:

Kriteret që duhet të plotsohen:

1. Kandidati duhet të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
2. Ti jet mbi 18 vjet (I moshes madhore)
3. Të ketë të përfunduar të paktën SHMP.



Komisioni për selektim përgatit listën e renditjes së kandidatëve dhe ia dorëzon kryetarit të komunës, i cili bën përzgjedhjen brenda 15 ditëve.

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kushte:

#### Kriteret:

1. Kandidati të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
2. Ti ket mbushur 18 vjet (i moshes madhore)
3. Të ketë të përfunduar të paktën AMP.
4. Kandidatët për trajnim duhet të jenë të aftë shëndetsor dhe psikofizike, përcaktuar nga institucioni shëndetësor i autorizuar në pajtim me ligjin.
5. Të mos ketë vendimi i formës së prerë i gjykatës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
6. Leja e vozitjes , kategoria C do të meret si përparësi .

#### Dokumentet e nevojshme:

- CV (biografi)
- Letër motivuese
- Aplikacioni
- Diplomë e arsimit të kryer përkatës
- Dokumentet që vërtetojnë se kandidati plotëson kriteret e lartpërmendura (1-6).

Vërejtje: Kandidatët e interesuar detyrimisht dokumentet e nevojshme duhet ti dorëzojnë në formë origjinale ose kopje të verifikuara.

Aplikacioni për Shpalljen Publike mund të shkarkohet nga uebfaqja zyrtare e Komunës së Vrapçishtit, <https://komunavrapcishte.gov.mk> ose në arkivin e Komunës së Vrapçishtit.

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhja e problemeve dhe vendosja për çështjet në kuadër të fushëveprimit të tyre,
- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritja e rezultateve,
- Puna me të tjerët/punë ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientimi drejt palëve të interesuara dhe
- Menaxhimi.



### Përshkrimi i procesit të trajnimit dhe përgjegjësi të kandidatëve të përzgjedhur

Kohëzgjatja e trajnimit (lënd mësimore): 720 orë, nga të cilat 620 orë i referohen pjesës teorike dhe 100 orë pjesës praktike.

Në vazhdim të pjesës teorike, kandidatët do të kenë mundësi të dëgjojnë lëndë nga arsimit i përgjithshëm, teoria profesionale, fusha e veçantë profesionale dhe praktika e specializuar, pra gjithsej 19 lëndë/module mësimore.

Vlerësimi dhe arritjet e kandidatëve në profilin arsimor Zjarrfikës Profesional kryhet në vazhdimësi gjatë procesit mësimor pas përfundimit të dëgjimit të secilit modul përmes monitorimit me gojë dhe verifikimit me shkrim të njohurive si dhe aftësi, aftësi për secilin modul.

Secili program I paraqitur /modul/ vlersohet me notë 1-5.

Pas realizimit të suksesshëm kandidatët i nënshtrohen një provimi specialistik sipas programeve të speciale të hartuara nga ZQZSH dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

#### Provimi përfundimtar përfshin:

- Pjesa teorike me test – kontrollimi I njohurive me shkrim
- Pjesa praktike përmes zgjidhjes së një rasti, kontrollimi i aftësi të fituara nga ushtrimet praktike.

Provimi mbahet para komisionit për provim në përputhje me programin e provimit.


Pas dhënies me sukses të provimit përfundimtar, kandidatët marrin **DIPLOMË PËR ARSIM SPECIAL - Zjarrfikës profesional.**

Afati përfundimtar për regjistrimin e shpalljes është 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e publikimit të tij. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet në momentin e paraqitjes së aplikimit.

Aplikimi me dëshmitë e nevojshme duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën: Komuna Vrapcisht Rr. "100" Nr. bb. me shënimin "Trajnim për zjarrfikësit".

Personi kontaktues: Abdulbari Ebibi.

Aplikimet jo ne afat të pa caktuar dhe dokumente të pa kompletuara nuk do të konsiderohen.

Kryetar  
  
Isen Shabani